

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.


Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Prill, 2024

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit priorizon Agjendën 2030 të Shqipërisë kundër korrupsionit dhe qeverisjen e mirë

01-30.4.2024: Grupi i Punës pranë Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion ka konsoliduar paketën e plotë të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030. Strategjia do të ketë tre qëllime të politikës parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim, të strukturuar në 17 objektivë specifikë. Pasaporta e Indikatorëve (dokument 1 shoqërues i strategjisë) përbëhet nga 40 indikatorë performance që do të masin nivelin e zbatimit të objektivëve përgjatë 7 viteve të zbatimit. Plani i Veprimit (dokument 2 shoqërues i strategjisë) përmban masa dhe aktivitete konkrete për tu kryer nga institucione të nivelit ekzekutiv qendror dhe vendor, nga autoritete të pavarura kushtetuese përfshirë institucione të pushtetit gjyqësor, mbi baza 6-mujore dhe vjetore. Strategjia do të përmbajë ndërhyrje për forcimin e zbatimit të ligjit me masa konkrete ligjore dhe institucionale për luftën ndaj korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes. Mekanizma dhe rregulla për respektimin e ligjit dhe rritjen e transparencës në vendimmarrje; aksesin e qytetarëve dhe gjithëpërfshirjen e shoqërisë civile në procesin legjislativ; vendimmarrjen e qeverisjes qendrore e vendore; parandalimin e konfliktit të interesit dhe lobimit për interesa private; thellimin e procesit të digjitalizimit të shërbimeve publike dhe kontrollin më të mirë ndaj tyre; përmirësimin e llogaridhënies dhe transparencës të pastërtisë së figurës së funksionarëve të lartë të zgjedhur ose të emëruar; forcimin e mekanizmave për kontrollin e integritetit të funksionarëve e zyrtarëve të të gjitha niveleve; ngritjen e mekanizmave funksionale për transparencën financiare dhe zhvillimin e kulturës e qasjes demokratike të partive politike; si dhe masa ligjore, institucionale dhe administrative për sektorët më vulnerabël ndaj korrupsionit (kadastra, taksat, doganat, arsimi, shëndetësia, përdorimi i fondeve publike e prokurimet publike), janë objektivat strategjisë në përmbajtje të saj. Strategjia do të nënshtrohet së shpejti një procesi konsultimi publik të hapur dhe të gjerë.



Tryezë për integritetin: Sektori publik dhe sektori privat bashkë kundër korrupsionit

29.4.2024: Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, zhvilloi takimin e parë për vitin 2024 me përfaqësues të sektorit privat në vend. Krerë të dhomave të tregtisë dhe drejtues e funksionarë të lartë të shoqatave të biznesit u ulën në këtë bashkëbisedim për të rakorduar urat e bashkëpunimit midis sektorit privat dhe drejtuesve të sektorit publik. Koordinim veprimesh, ndërhyrje dhe propozime për ndryshim, masa të mundshme ligjore, struktura dhe forcim rregullash ishin kryefjala e diskutimeve. "Tryeza për Integritetin: Sektori publik dhe privat kundër korrupsionit" rivjen si një nismë e këtij bashkëpunimi ku të dy sektorët priren të komplementojnë veprimtarinë e tyre, për të replikuar edhe në Shqipëri eksperiencat e mira të vendeve me standarde ndërkombëtare të UNCAC dhe OECD. Përfundimi i takimit dakordësoi organizimin e tryezave të rregullta sektoriale midis biznesit dhe administratës publike, ngritjen e një ekipi të përbashkët pune për të ndjekur me rigorozitet të gjitha zotimet në kuadër të rritjes së integritetit në sektorin publik dhe privat dhe organizimin e trajnimeve dhe seminare të organizuara së bashku. Kadastra, arsimi, shëndetësia, taksat dhe tatimet do të jenë në vëmendjen e bashkëpunimit publik-privat rregullisht.

"Edukimi kundër korrupsionit" tur takimesh dhe aktiviteteve në 10 shkolla të arsimit të mesëm në Shqipëri

11 - 30.4.2024: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ka zhvilluar një cikël takimesh në 6 shkolla të mesme të arsimit të lartë të Tiranës, 1 në Shkodër, 1 në Korçë dhe 2 në Vlorë, si përfitues direkte të projektit "Edukimi kundër korrupsionit".

Sipari i takimeve (11.4.2024) "Edukimi kundër korrupsionit" u çel në shkollën "Qemal Stafa" në Tiranë, me nxënës të klasave të 10-ta në ambientet e klasës digjitale. Nxënësit ishin partnerët e parë, të rinj, të përkushtuar, me dëshirë e ide për të promovuar luftën kundër korrupsionit për forcimin e standardeve të integritetit në shoqëri. Nxënësit përmes takimit patën mundësinë të takohen me ekspertë në fushën e luftës kundër korrupsionit nga të 3 institucionet nismëtare të marrëveshjes së bashkëpunimit, për kulturën e ligjshmërisë në shkolla dhe edukimin kundër korrupsionit, Ministria e Drejtësisë, e Arsimit dhe Sportit dhe të Ambasadës Italiane në Tiranë.



Takim i dytë i ditës (11.4.2024), u zhvendos në auditorin e sallës së teatrit të shkollës "Ismail Qemali", ku pjesëmarrësit u ndalën te rëndësia e aktivizimit social dhe ndërgjegjësimi qytetar kundër korrupsionit. Vëmendja dhe gatishmëria e të rinjve për të ndjekur kurrikulën dhe vullneti për t'u bashkuar në nismat kundër korrupsionit u shoqërua me realizimet artistike të disa nxënësve, duke promovuar garancinë e pakthyeshme për një shoqëri me vlera të qëndrueshme. Të gjitha krijimet e nxënësve do të marrin pjesë në një aktivitet me karakter kombëtar në prani të autoriteteve nismëtare të projektit.

Në ditën e dytë të takimeve (12.4.2024) u zhvillua takimi i tretë në shkollën "Petro Nini Luarasi". Klasa pjesëmarrëse na mirëpriti në ambientet e bibliotekës së shkollës, me pyetje, ndërhyrje në diskutime, vëmendje dhe shënime. Gjatë këtij prezantimi u theksuan mënyrat e denoncimit të rasteve korruptive në administratën publike. Ekspertët italianë folën mbi zbatimin e programit mësimor, promovimin e ligjshmërisë dhe qytetarisë së përgjegjshme në shkolla, duke identifikuar çështje të mësimdhënies në lidhje me ligjin dhe të drejtat, si dhe ideuan disa veprimtari me nxënësit për edukimin antikorrupsion.



Dita (12.4.2024) vijoi me takimin e katërt në shkollën "Asim Vokshi". "Edukimi kundër korrupsionit" pati partnerë të rinjtë e përkushtuar, njohës të gjuhëve të huaja, që sollën njohuritë e tyre të eksploruara në literaturën e huaj duke sjellë idetë e tyre për të promovuar luftën kundër korrupsionit. Vizatime me imazhe, diçitura dhe mesazhe krijuese dhe ngacmuese në fushën e luftës kundër korrupsionit. Ministria e Drejtësisë risolli kërkesën e saj për të marrë indicie për të përcjellë mesazhet kundër korrupsionit, video ndërgjegjësuese dhe video informative për njësitë e specializuara kundër korrupsionit.


Takimi i pestë i projektit u zhvillua (15.4.2024) në shkollën "Eqerem Cabej", në një klasë mësimore. Fokusi i Drejtorisë Antikorrupsion dhe ekspertët e arsimit parauniversitar ofruan njohuri për nxënësit, mbi burimet dhe mjetet e duhura për të përcjellë kërkesën për bashkëpunim në familjet dhe ambientet e tyre shoqërore. Falë bashkëpunimit me ekspertët e fushës së ligjit dhe sigurisë nga partnerët italianë u thelluan elementët e procesit të mësimdhënies në krijimin e kulturës së ligjit, të qytetarisë së përgjegjshme aktive dhe të një shoqërie të pastër dhe të ndershme. Ekspertët italianë prezantuan dy video nga veprimtaria e "Guardia di Finanza" gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre kundër subjekteve të ndryshme me veprimtari kriminale.



Takimi me nxënësit e klasave të 10-ta të shkollës "Myslym Keta", e çoi në 6 numrin e shkollave të arsimit të mesëm të Tiranës (15.4.2024) i mbajtur për "Edukimi kundër korrupsionit". Stafi i politikave kundër korrupsionit bashkë me kolegët italianë, ekspertë profesionistë në fushën e ligjshmërisë, informuan dhe dhanë leksionet për rolin që pritet nga të rinjtë në forcimin e integritetit të shoqërisë dhe të familjes. Bisedë e rrjedhshme dhe liri mendimesh shoqëruan takimin nën skenografinë e punëve krijuese të nxënësve. Në përfundim të takimit u bë e mundur shpërndarja e materialeve antikorrupsion të botuara nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, gjithashtu.




Në datë 29.4.2024, "Edukimi kundër korrupsionit" vijoi në shkollën "29 Nëntori" të Shkodrës, në takimin tonë të shtatë. Auditori i një klase të lëndës shkencore si matematika u kthye në skenografinë e një takimi njohës dhe prezantues të kurrikulës antikorrupsion të prezantuar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion. Mësuesit e qytetarisë dhe gjuhës italiane të shkollës lehtësuan takimin dhe angazhuan nxënësit në prodhimin e videove ose punimeve artistike për projektimin e fushatave kundër korrupsionit për tu shpërndarë në vijim. Vlerat e drejtësisë dhe të përgjegjësisë morale e sociale ishin kërkesa dhe nevojat për bashkëpunim mes tyre.



Takimi i tetë u zhvillua në formatin *online* me auditor nxënësit e shkollës së mesme "Themistokli Gërmenji" në Korçë, në të njëjtën datë (29.4.2024). Me ndihmën e teknologjisë dhe infrastrukturën e shkollës, nxënësit e klasave të 10-të aksesuan takimin tonë dhe u bashkuan interesit të moshatarëve të tyre, në shkollat e tjera të vendit. Pse duhet të luftojmë korrupsionin, vlerat dhe normat e shoqërisë, të drejtat dhe detyrimet dhe aktivizimi kundër korrupsionit patën interesin e nxënësve. Nevoja për përgjegjësi dhe kultura e ligjshmërisë për një qytetari të ndershme u përfaqëuan nga nxënësit e Korçës dhe mbetemi në pritje të takimit të radhës, me dëshirën për tu takuar fizikisht.

Në 30.4.2024, erdhëm në Vlorë, një takim që u mundësua në formë hibride. Në shkollën e mesme "Halim Xhelo", numëruam takimin tonë të nëntë, ku oficerët e agjencisë ligjzbatuese italiane në Shqipëri "Guardia di Finanza" iu bashkuan nxënësve dhe Ministria e Drejtësisë e Ministria e Arsimit dhe Sporti në formatin *online*. Dy video nga veprimtaria antikorrupsion dhe kundër krimit dhe të dhëna dhe informime për format e luftës kundër korrupsionit u ndanë për nxënësit. Pas përfundimit të prezantimeve u zhvillua një bisedë interaktive me nxënësit të cilët sollën shembuj nga eksperiencia e përditshme në shkollë në përballje me paligjshmëri dhe raste të dyshuara për korrupsion.





Takimi i nëntë i muajit prill (30.4.2024) u zhvillua dhe mbylli ciklin e takimeve në shkollën "Ali Demi", Vlorë. Klasa e 10-të e përfshirë në projekt, përmes takimit të zhvilluar në orën e lëndës "Qytetaria" pati mundësinë të dëgjojë nga ekspertë të fushës kundër korrupsionit dhe të kulturës së ligjshmërisë informacione dhe eksperiencia nga dita dhe puna e tyre, në Shqipëri dhe në Itali. Përfaqësuesit e "Guardia di Finanza", iu bashkuan fizikisht nxënësve me përcjelljen e videove informuese nga lufta kundër aktiviteteteve kriminale. Ministria e Drejtësisë kërkoi bashkëpunimin e nxënësve për të ideuar ndërhyrje dhe angazhime kundër korrupsionit në eventin përmbyllës të këtij viti shkollor.

Pas takimeve të Tiranës, Shkodrës, Korçës dhe Vlorës, "Edukimi kundër korrupsionit" do të vijojë zbatimin në dy shkolla të tjera të arsimit të mesëm, në Durrës dhe në Gjirokastrë, në muajin maj.

Kurrikula antikorrupsion për pikat e kontaktit kundër korrupsionit, cikël trajnimi me 6 seanca

28.3-19.4.2024: Shkolla Shqiptare e Administratës Publike - ASPA organizoi dhe ofroi ciklin e plotë të trajnimit për pikat e kontaktit antikorrupsion, me temë "Antikorrupsioni: Mekanizmat, Praktikrat, Mbrojtjet". Kurrikula e ofruar *online*, u nda në 6 seanca dhe u ndoq nga 20 pjesëmarrës, stafe në nivele të ndryshme të administratës. Punonjës të ministrive, varësi të ministrive dhe institucione të pavarura u regjistruan dhe ndoqën këtë trajnim, nën mentorimin e drejtorit të Politikave Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë. Kurrikula përbëhej nga 6 tema trajnimi: (1) Roli i pikave të kontaktit antikorrupsion si hartues të politikave, (2) Roli i pikave të kontaktit antikorrupsion në lehtësimin e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit, (3) Mekanizmat e integritetit si instrumente të luftës kundër korrupsionit, (4) Transparenca dhe deklarimi (kontrolli) i pasurisë si instrumente të luftës kundër korrupsionit, (5) Etika dhe sinjalizimi si dy instrumente të luftës kundër korrupsionit, (6) Antikorrupsioni dhe grupet e interesit. Pjesëmarrësit në përfundim të trajnimit u pajisën me certifikatë trajnimi, të vlefshme për të demonstruar njohuritë e tyre dhe promovuar angazhimin në rrjetin e pikave të kontaktit antikorrupsion. Forcimi i kapaciteteve të stafeve administrative për fushën dhe e ndarë sipas niveleve është një risi e kurrikulës së trajnimit të përgatitur nga ASPA dhe e cila po aplikohet rregullisht.



Grupi Drejtues i RAI dakordëson takimin e ardhshëm në Tiranë

18.04.2024: Iniciativa Rajonale Antikorrupsion – RAI, zhvilloi takimin e 43 të Grupit Drejtues, ku Shqipëria është anëtare prej vitit 2007. Ky takim ishte për diskutimin e ecurisë së aktiviteteteve të RAI për vitin 2023, diskutimin e planit të punës për dy vitet në vijim 2024 e 2025, riorganizimin e mundshëm strukturor të organizatës dhe vendosjen e bashkëpunimit me organe të tjera homologe. Tirana do të jetë vendi pritës dhe ku do të zhvillohet takimi i ardhshëm i Grupit Drejtues të RAI, në vjeshtë të vitit 2024, (tetor-nëntor). Propozimi i përfaqësuesit të Shqipërisë për tu mbledhur në kryeqytetin shqiptar u mirëprit pa asnjë debat nga vendet e tjera, duke promovuar edhe me këtë rast që ecuria e reformave dhe punëve të fushës është një tregues i mirë dhe bindës që rajoni të mblidhet në Tiranë për të folur për punët e mira dhe planet e së ardhmes. RAI është organizata rajonale që promovon dhe nxit nisma dhe politika antikorrupsion ku vendet orientojnë ndërhyrje për veprime dhe masa. Edukimi dhe ndërgjegjësimi kundër korrupsionit, instrumentet e vlerësimit të riskut për korrupsion në fusha dhe sektorë të ndjeshëm si dhe ngritja e strukturave për më shumë operacionalitet janë fusha ku RAI interferon ndjeshëm në rajon.

